



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI PORTUAL Durrës

Nr. _____ Prot.

Durrës, më _____._____.2026

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIMIT**

(Bazuar në Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik me Nr.794/2026 dhe Nr. 908/2026)

Data: / / 2026

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE) “Optima Communication” Shpk, me Nipt K71903025A me adresë: Tirane
Tirane Rruga Shyqyri Berxolli, Pallati Inter Co-Sat, Seksioni B, Kati i 6-të, Nr. 6/5, Dera 28B, Tiranë,
Shqiperi

E-Mail: info@optima.al

Telefon: 0672044803

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: Mallra

Lloji i Procedurës së prokurimit: “Procedurë e Hapur”

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **REF-71079-12-04-2025**
“Digital Port” - 5 (pesë) muajsh kalendarikë, nga data e nënshkrimit të kontratës.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 05.12.2025

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike Nr.78 datë 9 Dhjetor
2025

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. BOE “Idealdevs Corporation” Shpk, me Nipt M38106801F dhe “Ervald Rosaj” me Nipt M32118010E me vlerë të ofertës ekonomike 9.343.900 (Nëntë milionë e treqind e dyzet e tre mijë e nëntëqind) lekë, pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

2. “PC STORE” Shpk, me Nipt L01606034A me vlerë të ofertës ekonomike 9.600.000 (Nëntë milion e gjashtëqind mijë) lekë, pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

3. “ATOM” Shpk, me Nipt L22203042N me vlerë të ofertës ekonomike 11.800.000 (Njëmbëdhjetë milion e tetëqind mijë) lekë, pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO ☒

4. “Optima Communication” Shpk, me Nipt K71903025A me vlerë të ofertës ekonomike 12.400.000 (Dymbëdhjetë milion e katërqind mijë) lekë, pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____
(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO ☒

5. “INSTANT.AL” Shpk, me Nipt L81506043D me vlerë të ofertës ekonomike 13.270.000 (Trembëdhjetë milionë e dyqind e shtatëdhjetë mijë) lekë, pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____
(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO ☒

6. “Cactus” Sh.a, me Nipt 810486664 me vlerë të ofertës ekonomike 13.524.753,67 (Trembëdhjetë milion e pesëqind e njëzet e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre presje gjashtëdhjetë e shtatë) lekë, pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____
(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO ☒

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

Bazuar në procesverbalin e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, datë 09/02/2026:

1. “ATOM” SHPK

L22203042N

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

arsyet e mëposhtme

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Operatori Ekonomik “**ATOM**” SHPK, Duke u bazuar në kriterin 2.3.3/e të Dokumenteve Standarde të Tenderit, i cili përcakton se operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në Oracle Database Administrator, konstaton sa vijon:

Nga dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik rezulton se për këtë kriter janë dorëzuar certifikime Microsoft Azure, konkretisht për:

- Azure Database Administrator Associate
- Azure Developer Associate
- Azure Cosmos DB Developer Specialty

Nga pikëpamja teknike, Komisioni vëren se certifikimet e paraqitura:

- kanë në fokus platformën Microsoft Azure dhe shërbimet cloud të saj;
- lidhen me administrimin e databazave Azure (PaaS) dhe zhvillimin e aplikacioneve në ekosistemin Azure;
- nuk provojnë kompetenca në administrimin e Oracle Database.

Administrimi i Oracle Database përfshin njohuri dhe aftësi specifike si:

- konfigurim dhe administrim të instancave Oracle;
- backup, restore dhe recovery të databazës Oracle;
- performance tuning, security dhe user management në Oracle RDBMS;
- integrim të drejtpërdrejtë të aplikacioneve me databaza Oracle ekzistuese.

Certifikimet Azure, përfshirë Azure Database Administrator ose Cosmos DB, janë teknologjikisht të ndryshme dhe jo të ndërkëmbyeshme me Oracle Database Administrator. Për rrjedhojë, ato nuk mbulojnë objektin teknik të kriterit 2.3.3/e.

Nga pikëpamja ligjore, kriteri është i formuluar qartë : kërkohet Oracle Database Administrator.

Paraqitja e certifikimeve Azure përbën:

- mos-përputhje të drejtpërdrejtë me kërkesën e DST;
- mosplotësim substancial të kriterit, pasi nuk vërtetohet kompetenca thelbësore e kërkuar.

Fakti që një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime nuk ndryshon vlerësimin, pasi certifikimet e paraqitura nuk janë brenda fushës Oracle Database dhe për rrjedhojë nuk mund të konsiderohen ekuivalente.

Në përfundim, Komisioni konstaton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë certifikim të vlefshëm për Oracle Database Administrator, sipas kërkesës së përcaktuar në kriterin 2.3.3/e të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Certifikimet Microsoft Azure të paraqitura nuk janë ekuivalente dhe nuk zëvendësojnë certifikimin e kërkuar për Oracle Database Administrator.

Kriteri 2.3.3/e nuk pranohet, duke sjellë skualifikimin e operatorit ekonomik për mosplotësim të kriterit si më lartë.

2. “Cactus” Sh.a

810486664

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

arsyet e mëposhtme

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Operatori Ekonomik **“Cactus” Sh.a**, nuk përmbush të gjitha kriteret e kërkuara në dokumentat e tenderit, konkretisht si mëposhtë:

1. Për kriterin 2.3.3 /c Certifikim për sisteme operative për servera (Windows Server, Linux)

Në Dokumentet Standarde të Tenderit është përcaktuar kërkesa për certifikim të drejtpërdrejtë dhe specifik në administrimin e sistemeve operative për servera (Windows Server dhe/ose Linux), me qëllim garantimin e konfigurimit, operimit dhe sigurisë së platformës objekt kontrate. Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se janë dorëzuar certifikime të tipit:

- Network+
- Security+

Komisioni vlerëson se këto certifikime:

- Kanë fokus kryesisht në rrjete kompjuterike dhe siguri informacioni;
- Nuk përfshijnë administrimin praktik të sistemeve operative serverash;
- Nuk provojnë aftësi në konfigurimin e OS, hardening, menaxhim shërbimesh, patching, logging, troubleshooting dhe operim të vazhdueshëm të serverëve.

Nga pikëpamja teknike, Network+/Security+ nuk janë ekuivalente me certifikime për administrim të sistemeve operative serverike. Nga pikëpamja ligjore, paraqitja e këtyre certifikimeve përbën mos-përputhje të drejtpërdrejtë me kërkesën specifike të kriterit 2.3.3 /c.

Për rrjedhojë, kriteri 2.3.3 /c vlerësohet nuk pranohet.

2. Për kriterin 2.3.3 /d Certifikim për baza të dhënash

DST kërkon certifikim profesional për specialist në administrimin e bazave të të dhënave, i aftë për menaxhim, konfigurim, siguri dhe operim të databazave që mbështesin sistemin.

Nga dokumentacioni i paraqitur janë dorëzuar:

- *Udemy: Learn SQL – The Hands-on Guide with Interactive Exercises*
- *Astronomer Certification for Apache Airflow 2 Fundamentals*
- *Database Design and Basic SQL in PostgreSQL* (kurs online pa kredi akademike, University of Michigan – Coursera)

Komisioni konstaton se këto dokumente:

- Janë kurse online/trajnime përgatitore;
- Nuk përbëjnë certifikime profesionale të standardizuara;
- Nuk ofrojnë provim të detyrueshëm të certifikuar apo verifikim zyrtar të kompetencës;
- Fokusohen në njohuri bazë ose tematike (SQL, dizajn database, workflow orchestration), jo në administrim profesional të databazave.

Nga pikëpamja ligjore, këto dokumente nuk plotësojnë kriterin e certifikimit profesional, pasi nuk përfaqësojnë prova formale dhe të verifikueshme të kualifikimit teknik.

Për rrjedhojë, kriteri 2.3.3 /d vlerësohet nuk pranohet.

3. Për kriterin 2.3.3 /e Certifikim për specialist të certifikuar në Oracle Database Administrator

DST parashikon në mënyrë të qartë kërkesën për Oracle Database Administrator, si rol kritik për administrimin e databazës Oracle.

Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton certifikimi:

- Oracle Certified Professional: Oracle Linux 8 System Administrator

Komisioni vëren se ky certifikim:

- Ka në fokus administrimin e sistemit operativ Linux;
- Nuk mbulon administrimin e databazave Oracle;
- Nuk provon kompetenca në Oracle Database (instance management, backup/recovery, performance tuning, security, user management).

Nga pikëpamja teknike, administrimi i OS Linux dhe administrimi i Oracle Database janë fusha të ndryshme, me kompetenca dhe përgjegjësi të ndara. Nga pikëpamja ligjore, paraqitja e këtij certifikimi përbën mosplotësim substancial të kriterit, pasi nuk është ekuivalent me kërkesën për Oracle Database Administrator.

Për rrjedhojë, kriteri 2.3.3 /e vlerësohet nuk pranohet.

Në përfundim, Komisioni konstaton se për kriteret 2.3.3/c, 2.3.3 /d dhe 2.3.3 /e, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat teknike dhe ligjore të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit.

Bazuar në Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 330/2026, protokolluar nga Autoriteti Portual Durrës me Nr. 800, datë 05.03.2026 dhe në procesverbalin e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, datë 06/03/2026:

3. BOE “Idealdevs Corporation” SHPK M38106801F

“Ervald Rosaj” SHPK M32118010E

Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it arsyet e mëposhtme

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Referuar përcaktimeve të nrnit 93 të Ligjit nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, dhe të nenit 82, pika 4, shkronja b), të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar KVO konkludon se oferta e paraqitur nga BOE Idealdevs Corporation dhe Ervald Rosaj është ulur me shumë se 85% e mesatares se ofertave të vlefshme, pra është anomalisht e ulët.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Për rrjedhojë KVO vendosi të mos kualifikojë ofertën e paraqitur nga OE Idealdevs Corporation si ofertë anomalisht të ulët.

Bazuar në Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 794/2026, protokolluar nga Autoriteti Portual Durrës me Nr. 2140, datë 18.06.2026 dhe në procesverbalin e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, datë 26/06/2026:

4. “PC STORE” SHPK L01606034A

Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it arsyet e mëposhtme

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Duke u bazuar te Vendimi Nr. 794/2026, protokolluar nga Autoriteti Portual Durrës me Nr. 2140, datë 18.06.2026, Komisioni i Prokurimit Publik ka vlerësuar se dokumentacioni i “PC STORE” SHPK përmbush pjesërisht kriterin 2.3.3 për pikat a), b), c), e) dhe f). Megjithatë, për pikën f), e cila kërkon dy specialistë të certifikuar për zhvillimin e programeve web/mobile, është provuar plotësimi vetëm për një specialist.

Për rrjedhojë, “PC STORE” SHPK nuk përmbush në tërësi kriterin 2.3.3 dhe oferta e tij vijon të jetë e skualifikuar.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “OPTIMA COMMUNICATION” Shpk me NIPT K71903025A dhe me adresë: Tirane Tirane Rruga Shyqyri Berxolli, Pallati Inter Co-Sat, Seksioni B, Kati i 6-të, Nr. 6/5, Dera 28B, Tiranë, Shqiperi, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **12.400.000** (Dymbëdhjetë milion e katërqind mijë) lekë, pa tvsh, është identifikuar si ofertues i suksesshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Liburn Aliu